



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr prot. 06-32253 /2024

Datë: 24, 09 /2024

Duke u mbështetur në nenin 17 shkronjën k) dhe nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 17 të Rregullores Komunale për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve /2015, Nenin 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-049, kërkesën e kryetarit të komunës si dhe me rekomandimin e KPF-së të datës: 06.09.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e VIII-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më datën 20.09.2024, miratoi këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa 01Nr.360-28895/24 për mbështetje financiare për znj. Nazife Gucati, për pagesën e qirasë së banimit për një periudhë të caktuar kohore, në shumën prej 1,000.00 €. (njëmijë euro).
2. Shuma si në pikën një, të këtij vendimi i ndahet të lartpërmendurës për mbulimin e shpenzimeve të qirasë së banimit.
3. Mjetet financiare në shumë prej 1,000.00 € (njëmijë euro) ndahen nga Programi Zyra e Kryetarit (160), nën-programi (16018), kodi funksional (0111) në kategorinë e subvencioneve dhe transferëve.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

**Njoftohen:**

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Parashtruesja e kërkesës;
- Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



**Kryesues i Kuvendit  
Fadil Gashi**